



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 01/43**


**Datë: 05.08.2015**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në përputhje me nenin 40 të Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit Shtetëror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke ju referuar Vendimit të Qeverisë Nr. 05/28 të datës 08 maj 2015 si dhe duke pasur parasysh kompletimin e dokumentacionit në nivel teknik të Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e "Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me Qeverinë e Malit të Zi në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/43

Datë: 05.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/43

Datë: 05.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së madhe të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim "KSV/018: Mbështetje institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës".
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/43

Datë: 05.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 42/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit dhe Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë të Kosovës.
2. Obligohet Sekretariati dhe Qendra e Situatave e Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/43

Datë: 05.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Ilir Morina, i vazhdohet mandati i Kryeshefit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor edhe për tre (3) vjet.
2. Z. Morina kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/43

Datë: 05.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të Ndërmarrjeve Shoqërore "Auto Moto Kosova" dhe "INA Zagreb" të cilat preken nga ndërtimi i Objekteve Ndërtimore për nevoja të Qeverisë së Kosovës, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Qeveria e Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/43

Datë: 05.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 5 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: Pikat Kufitare Mutivodë, Zona Kadastrale Dabishec, Komuna Prishtinë, Bërnjak, Zona Kadastrale Banjë, Komuna Zubin Potok dhe Merdar Zona Kadastrale Merdar, Komuna Podujevë, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë